



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Prodato Received/Delivery	09.12.2023	3	viti god year
Organ /Rjeshta Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	7213/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1352/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1352/2023 të datës 30.10.2023 të parashtruar nga ankuesja ..., nga Gjakova, kundër Njoftimi të datës 12.09.2023 të Departamenti për Menaxhimin Zyrtarëve Publik, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.12.2023, mori këtë.

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1352/2023 e datës 30.10.2023 të parashtruar nga ankuesja ..,

Arsyetim

Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 05.05.2023 ka shpallur Konkursin për Pranim me numër reference RN00011612 për emrin e grupit, „Specialist të Arsimit“ për pozitën „Inspektor i Arsimit“ Klasa-Profesional në Sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Gjakovë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me afat për aplikim nga data 26.05.2023 deri me datë 05.06.2023,.

Në këtë procedurë pranimi ka qenë e përfshirë edhe ankuesja Mimoza Shala-Dajja e cila sipas shkresave të lëndës konkretisht me datën 10.07.2023 përmes Vendimit me NR.28/2023 i është refuzuar aplikacioni me arsyetim se e njëjta nuk i plotëson kushtet e konkursit respektivisht, e njëjta nuk e ka dorëzuar kopjen e dëshmisë se punësimi në sektorin privat të dëshmuar përmes trustit, ashtu siç është kërkuar në konkurs.

Ankuesja kundër Vendimit numër Nr28/2023 të datës 10.07.2023 lidhur me refuzimin e aplikacionit ka parashtruar ankesë tek Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, ndërsa Zëvendësuesja e Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP përmes Vendimit me Nr.14/2023 të datës 19.07.2023 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me NR.14/2023 të datës 19.07.2023 të Zëvendësueses së Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP me datën 18.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5719/2023 në Këshillin e Pavarur Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ndërsa me datë 02.10.2023 Këshilli i Pavarur Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka marr vendimin me numër A.nr.1090/2023 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankueses duke e obliguar Zëvendës Udhëheqësen e Divizionit për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit pranë MPB-së që brenda afatit 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të përfshijë ankuesen Mimoza Shala Dajja, në listën e ngushtë /të kandidatëve që kanë plotësuar kushtet në Konkursin me numër të referencës RN00011612 për emrin e grupit "*Specialistë të Arsimit*" lidhur me vendin e punës "*Inspektor i Arsimit*" në Rajonin e Gjakovës.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me date 24.10.2023 ka zbatuar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës duke publikuar njoftimin e datës 27.11.2023 në të cilin ankuesja është përfshirë në listën e ngushtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.09.2023, ka proceduar kërkesën e ankueses për përgjigje në ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publik. Ndërsa Këshilli më datë 14.11.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6762/2023 të datës 30.10.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër A.Nr.1090/2023 të datës 02.10.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 12.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.09.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 14.11.2023; Konkursin e shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme me numër reference RN00011612 të datës 05.05.2023; Vendimin me numër 05/151 të datës 12.07.2023 për Emërimin e Komisionit të Pranimit; Njoftimin e datës 10.07.2023; Njoftimin e datës 19.07.2023; Njoftimin e datës 12.09.2023; Vendimin e datës 11.09.2023; Renditjen



përfundimtarë të datës 11.09.2023; Emalin e datës 10.11.2023 të A. _____ drejtuar M. _____
Emalin e datës 13.11.2023 të A. _____ drejtuar B. _____; Vendimin e datës
02.10.2023; Vendimin e datës 02.11.2023; Aplikacionin e ankueses; Diplomën me numër
protokolli 333 të datës 20.06.1195 të lëshuar nga SH.M.M "Hysni Zajmi" Gjakovë për M.D;
Kontratën për punë individuale me kohë të plotë me numër protokoli 20/070152 të lidhur
mes M.D dhe Q.E.A "Gulistan"; Kopjen e letërnjoftimit të M.D; Referencën me numër
protokolli 90 të datës 29.05.2023 të lëshuar nga "Mehmet Akif School" për M.D; Vendimin
me numër protokoli 1242/1 të datës 20.08.2021 të lëshuar nga "Mehmet Akif School" për
M.D; Vendimin me numër protokoli 05/151 të datës 12.07.2023 të Qeverisë së Republikës së
Kosovës; Listën e aplikantëve me kandidatet e aprovuar dhe kandidatët e refuzuar;
Njoftimin e datës 10.07.2023 të DMZP-së; Diplomën me numër 632 të datës 24.07.2018 të
Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti i Filologjisë, me titull Master i
Shkencave Filologjike për M.SH-D; Diplomën me numër 1374 të datës 20.01.2023 të lëshuar
nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti i Edukimit, me titull Master i
Mësimdhënies në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, për M.D; Mirënjohjen e datës 31.05.2012 të
Këshillit Studentor të Fakultetit të Edukimit për M.SH-D; Licencën e mësimdhënësit me
numër 1028463 të datës 05.11.2020 të M.D; Certifikatën e muajit dhjetor 2022 të lëshuar nga
Qendra për avancimin e performancës së arsimit "QAPA" për M.SH-D; Modulet e trajnimit;
Certifikatën e vitit 2017 të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për
M.D; Kontratën punë me numër protokoli 22/101837 të lidhur mes Q.E.A "Gulistan" O.P
dhe M.D; Vërtetimin me numër protokoli 50 të datës 28.03.2023 të lëshuar nga "Mehmet
Akif School"; Vlerësimin e punës për dy vitet e fundit me numër protokoli 91 të datës
29.05.2023 të lëshuar nga "Mehmet Akif School" për M.D; Dëshminë për masë disiplinore
me numër protokoli 89 të datës 29.05.2023 të lëshuar nga "Mehmet Akif School" për M.D;
Vendimin me numër K975 të datës 15.04.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së
Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Marrëveshjen për shërbime të veçanta me numër 2-975
të datës 26.04.2014 të lidhur mes MASHT dhe M.D; Vendimin me numër 04 të datës
11.03.2014 të Kuvendit Komunal të Gjakovës; Emalin e datës 29.11.2023 të A.
drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 27.11.2023 të _____ i drejtuar A. _____ Emalin
e datës 10.11.2023 të A. Kamberaj drejtuar _____ a; Emilin e datës 24.10.2023 të
drejtuar _____; Njoftimin e datës 27.11.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e
bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin për të cilin ka filluar procedimi
administrativ me ankesën e ankuesit, është *bërë i pamundur, sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të
Kosovës pretendon se është e pakënaqur me publikimin e listës përfundimtare për
kandidatin e përzgjedhur për grupin *Specialist i Arsimit* për pozitën "*Inspektor i Arsimit*", në
Rajonin e Gjakovës, pa e përfshij ankuesen në listën e ngushtë sipas Vendimit me numër
A.nr.1090/2023 të datës 02.10.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të
Kosovës.



Nga administrimi shkresave të parashtruara nga ankuesja si dhe organi i punësimit Kolegji ka gjetur se me datë 24.10.2023 Departamenti për Menaxhimin Zyrtarëve Publik ka zbatuar Vendimin me numër A.nr.1090/2023 të datës 02.10.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen se sipas vendimit të lartpërmendur është përfshire në listën e ngushte për grupin *Specialist i Arsimit* për pozitën "*Inspektor i Arsimit*", në Rajonin e Gjakovës, ndërsa me date 27.11.2023 është publikuar Njoftimi për listën e ngushte pas plotësimit dhe ndryshimit të kësaj liste pas afatit të ankesave respektivisht zbatimit të Vendimit me numër A.nr.1090/2023 të datës 02.10.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku është përfshirë edhe ankuesja dhe e njëjta është ftuar për test me shkrim për datën 29.11.2023, ku pjesëmarrjen e në test me shkrim e ka konfirmuar edhe ankuesja.

Andaj në rrethanat e rastit konkret lidhur me pretendimet ankimore të ankueses sikurse edhe me objektin e shqyrtimit të ankesës së saj, gjegjësisht konkursin për grupin *Specialist i Arsimit* për pozitën "*Inspektor i Arsimit*", në Rajonin e Gjakovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se është vendosur sipas Vendimit me numër A.nr.1090/2023 të datës 02.10.2023, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës gjegjësisht aktet e nxjerrja si rezultat i kësaj procedurë janë anuluar siç është cekur si më lartë dhe Divizioni për Zhvillim e Rekrutimit dhe Inspektimit /DMZP, e ka zbatuar vendimin e Këshillit, konkretisht duke ndërmarr veprimet si në pikën III të këtij vendimi.

Prandaj nga se u tha si më lartë, pas rrethanave të krijuara juridike e në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*", Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse sipas Vendimit me numër A.nr.1090/2023 të datës 02.10.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është vlerësuar se ankuesja duhet të jetë pjesë e listës së ngushtë lidhur me konkursin në fjalë dhe se Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik e ka zbatuar vendimin e Këshillit, konkretisht sipas Njoftimit të datës 27.11.2023 për listën e ngushte ankuesja është renditur me numër rendor 21 në listën e ngushtë dhe e njëjta ka marrë pjesë në testin me shkrim të datës 29.11.2023 atëherë ankesa e ankueses nuk ka objekt shqyrtimi dhe mbi këtë bazë objekti i ankesës është bërë i pamundur apo i kotë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1352/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Proçesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.